



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

AKT NORMATIV

Nr. 10 datë 18.12.2019

**PËR
DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998,
PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 8/1, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme, Mënyra e përfitimit për kategoritë sipas kësaj pike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Pas nenit 8/1 shtohet neni 8/2, me këtë përmbajtje:



"Neni 8/2

1. Për të përfituar nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë;
 - b) Të jenë pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë
 - c) Të mos kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie;
 - d) Të kenë marr përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit. Kërkesa e palëve të interesuara duhet të shoqërohet me dokumentet provuese për parashikimet e shkronjave “a”, “b” e “c”, të kësaj pike, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm.
2. Strukturat e organeve tatimore janë përgjegjëse dhe garantojnë trajtim të barabartë të çdo kërkesë të depozituar nga palët e interesuara për të qenë përfitues nga zbatimi i këtij ligji. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave- Administrative.
3. Personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, humbasin të drejtën e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat në kushtet e mosripërtëritjes së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, kur për këtë nuk është bërë kërkesë në strukturat përgjegjëse deri 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të lejes. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.”.



Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO